

V E N D I M
Nr. 415, datë, 26.8.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 791, DATË 24.12.1998 “PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 694, DATË 21.10.1996 “PËR NORMËN MËSIMORE E SHKENCORE NË SHKOLLAT E LARTA DHE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR, PAGIMIN E ORËVE SUPLEMENTARE, AKTIVIZIMIN E PENSIONISTËVE DHE PUNONJËSVE TË JASHTËM NË SISTEMIN E ARSIMIT””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 7810, datë 6.4.1994 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 791, datë 24.12.1998 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 694, datë 21.10.1996 “Për normën mësimore shkencore në shkollat e larta dhe në arsimin parauniversitar, pagimin e orëve suplementare, aktivizimin e pensionistëve dhe punonjësve të jashtëm në sistemin e arsimit”, pika 1 germa “b”, ndryshohet si vijon:

“b. Në shkollat e larta, sasia e orëve mësimore mbi normën e miratuar, lejohet sipas nevojave të shkollës deri në masën 45 për qind dhe, për raste të veçanta, me miratim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës lejohet jo më shumë se 70 për qind e normës. Vetëm për vitin mësimor 1997 – 1998, orët mësimore suplementare të paguhen mbi masën 70 për qind, me miratim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës”.

2. Efektet ekonomike të përballohen nga buxheti i planifikuar për vitin 1999 për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko